

## **B.E.K.O.J. (java 3 nga 6)**

### **E - E Dëgjoj Tjetrin**

Mirë se erdhe në kishën tonë! Përshëndetje e veçantë për çdo person që është për herë të parë sot. Kemi filluar një seri të re dhe uroj që do të jetë inkurajim për ty dhe uroj që do na ndjekësh javë pas jave.

Seria quhet B.E.K.O.J. Çdo javë po fokusohemi në një nga shkronjat e kësaj fjale dhe do e ilustruonim me një histori nga jeta e Jezusit. Gradualisht do të shikojmë që secili prej nesh ka një mision të dhënë nga Jezusi në jetën e tij. Kur ti zgjedh Perëndinë, Ai e bekon jetën tënde, por nuk mbaron aty. Ai dëshiron që pastaj të bekojë të tjerët nëpërmjet teje. Siç thuhet te Zanafilla 12:2-3:

"Unë do të bekoj ... dhe të gjithë njerëzit e tokës do të bekohen nëpërmjet teje.

**Do të të bekoj që të jesh bekim.**

Të dielën e shkuar, folëm për shkronjën e parë të fjalës BEKOJ.

#### **B – Bjer në gjunjët e lutjes.**

Nga ana praktike, kjo do të thotë që ti e fillon çdo ditë duke iu drejtuar Perëndisë me një lutje të thjeshtë por të fuqishme: "Perëndia im, si do ti që ta bekoj botën sot?"

Dua shumë t'ju nxis gjatë këtyre 3 javëve të mbetura, që ta filloni çdo ditë me këtë lutje: "Si do ti, Perëndi, çfarë të bëj, kë të bekoj sot?" Dhe do të habiteni për mundësitë që do të krijojnë Perëndia.

#### **(shënim: mund të pyesni persona nga kisha juaj)**

Pyetëm disa nga ju si ju ka përdorur Perëndia për të bekuar dikë dhe ja si jeni përgjigjur disa prej jush:

- Kam ndihmuar një shokun tim që po kalon disa sfida, dhe në fakt, ndërkohë që po ndihmoja atë, kjo ka ndikuar pozitivisht edhe tek unë.
- Po ndihmoj disa persona që kanë provime.
- Këtë javë kam ndihmuar shoqen e dhomës sepse ajo po kalon një situatë të vështirë, madje e kam ftuar të vijë në kishë.
- Takova një shoqe që do të ikte në Itali dhe kishte nevojë të fliste dhe të ndante gjërat që po kalonte dhe që e shqetësonin lidhur me një person të besueshëm të saj. Ajo iku e inkurajuar dhe e lehtësuar.
- Ndhimova dikë me hapa praktikë se si të studiojë Biblën.
- Kam gatuar për dikë që ishte e sëmurë dhe ajo u kënaq shumë.
- U luta për një fëmijë që ishte në gjendje kritike për jetën dhe morëm përgjigje që ishte më mirë.
- Perëndia gjatë kësaj jave më ka drejtuar të dëgjoj çdo hall të një personi dhe ta këshilloj, t'i mësoj cila është rruga e duhur për të jetuar sipas parimeve të Perëndisë.

Zoti është i mirë; Ai do të bekojë më shumë, sepse e sheh që ti di si të menaxhosh bekimet që të jep Ai. Ai do të bekojë që ti të jesh bekim. Në fjalën BEKOJ, sot do të shikojmë shkronjën e dytë, E. E, nuk ka lidhje me isot e këngëve të jugut, eee. E-ja është...

### **E – E dëgjoj tjetrin.**

Që ti dhe unë të jemi bekim për këtë vend, të jemi bekim për njerëzit që na sjell Perëndia në jetën tonë, duhet të bëhemi dëgjues të mirë. Ajo që do të shikojmë gjatë kësaj serie - si javën e shkuar që ti lutesh dhe e fillon ditën me lutjen: "Zot, cilin të bekoj sot?" - dhe mesazhi i sotëm, "E dëgjoj tjetrin", bashkë me tre pjesët e tjera që do të vijojnë, janë aq të thjeshta dhe aq praktike.

Po ku e gjejmë idenë 'E dëgjojmë tjetrin'?

**Jezusi dhe i Verbëri.** Ja një histori e njohur në Bibël që tregon se vetë Jezusi ishte dëgjues i mirë.

**Luka 18:35-36** *Tani ndërsa ai po i afrohej Jerikos, një i verbër ishte ulur përgjatë rrugës dhe po lypte; dhe kur dëgjoji se po kalonte turma, pyeti çfarë ishte;*

**37-38** *iu përgjigjën se po kalonte Jezusi nga Nazareti. Atëherë ai bërtiti duke thënë: "O Jezus, Bir i Davidit, ki mëshirë për mua"*

**39-40** *Ata që ecnin përpara i bërtitën të heshtte, por ai bërtiste edhe më fort: "O Bir i Davidit: ki mëshirë për mua". Atëherë Jezusi ndaloi dhe urdheroi t'ia sillnin dhe, kur ai iu afrua, e pyeti...*

Një sekondë, se mos na ikin disa detaje pa i vënë re. Jezusi nuk doli nga shtëpia dhe tha: "Sot kam vendosur të shëroj dikë." Jo, ai ishte në rrugë për në Jeriko, që ishte qyteti përpara Jeruzalemit. Nëse Jezusi, le të themi, po vinte nga lindja, nga Korça, i bie që po kalonte në Elbasan, rrugës për të ardhur në Tiranë. Jezusi po shkonte në Jeruzalem për festën e Pashkëve. Për shkak të kësaj feste, rrugët ishin plot me njerëz. Jeriko ishte një qytet i madh në atë kohë. Imagjino Elbasanin gjatë festës së Ditës së Verës, plot me njerëz; kështu ishte Jeriko në këtë periudhë të vitit, shumë, shumë njerëz që udhëtonin për të shkuar dhe për të festuar Pashkën në Jeruzalem. Dhe në mes të gjithë asaj turme është edhe një i verbër, që sapo dëgjon se po kalonte Jezusi rrugës, fillon të thërrasë: "*Ki mëshirë për mua!*"

Dhe, pavarësisht zhurmës që krijonte turma përreth, Jezusi e dëgjoji këtë djalë. Mund ta imagjinoj Jezusin në këtë moment, si të shkosh në çerdhe ose në shkollë për të marrë fëmijën tënd, dhe të mund ta njohësh nga zëri, pa e parë fare, thjesht nga zëri e di që ai është fëmija yt. Jezusi dëgjoji zërin e një burri që thërriste për ndihmë ndërsa ai po kalonte rrugës.

Njerëzit që udhëtonin bashkë me Jezusin i thanë: “O djalë, lëre Jezusin rehat; kemi gjithë ditën që ecim dhe jemi të lodhur. Jezusi është i ngarkuar, po shkojmë të hamë diçka, se s'kemi ngrënë as drekë, dhe duhet të bëjmë rrugë.” Por ky burrë, zëre se i the, “Bërtit më fort!” Filloi të thërrasë me gjithë fuqinë që kishte: “Jezus, Biri i Davidit, ki mëshirë për mua!” Dhe ja se çfarë ndodhi më pas.

## **Luka 18:40-42**

*Jezusi ndaloi dhe e pyeti duke thënë: Çfarë dëshiron të bëj për ty? Dhe ai tha: Zot, të rimarr dritën e syve. Dhe Jezusi i tha: Rimerr dritën e syve, Besimi yt të shëroi.*

**42.** *Në çast rimori dritën e syve dhe e ndiqte duke përlevduar Perëndinë; dhe gjithë populli, kur pa këtë, i dha lavdi Perëndisë.*

Me shumë gjasa, ti e dije përfundimin e historisë: një burrë i verbër takon Jezusin dhe Jezusi e shëron atë. Dhe kaq ishte, kalojmë në historinë tjetër. Jo, jo, prit pak. Ajo që dua të shikojmë bashkë është pyetja në vargun 40: "Çfarë dëshiron të bëj për ty?"

Duket si një pyetje pa lidhje? Çfarë mund të kërkonte një i verbër nga Jezusi? “Jezus, desha një vend pune kamerier në Jeruzalem, a njeh ndonjë aty, tek Sofra e Ariut, që është afër me autobus për në Elbasan?” Sigurisht që i verbëri donte sy.

Por pse Jezusi e pyeti të verbën: “Çfarë do që të bëj për ty?” Ajo që mendoj unë, dhe që është e rëndësishme për atë që do të ndaj me ju, është se Jezusi e bënte shpesh këtë pyetje. Ai nuk hamendësonte se “Unë e di se çfarë kanë nevojë njerëzit.” Jo, ai i pyeste herë pas here: “Çfarë mund të bëj për ty?” dhe i dëgjonte cilat ishin nevojat e tyre.

Të gjithë e dimë sa i rëndësishëm është dëgjimi i njerëzve të afërt. Ka shumë gjasa që ti i ke thënë dikujt: “Ti kurrë nuk dëgjon se çfarë them unë.” Ose, ne që jemi prindër, mund të themi: “Po, po, më dëgjo më mirë këtu.” “Po, po, o babi, po të dëgjoj,” dhe vazhdon të luajë me celularin akoma.

Të dëgjosh se çfarë ka një person afër teje për të thënë është e rëndësishme. Por le të shikojmë një hap më tej, sepse jemi në serinë BEKOJ dhe dëgjimi është shumë i rëndësishëm në misionin që Jezusi ka për jetën tonë. Jezusi tha: “Çfarë dëshiron të bëj për ty?” Dhe Ai dëshiron që ne të kemi të njëjtin qëndrim, të dëgjojmë njerëzit përreth nesh dhe të kuptojmë se çfarë nevojash kanë. Nuk do ta mësosh kurrë nëse nuk i pyet.

Shpesh, ne mendojmë se e dimë se çfarë nevojash kanë njerëzit dhe bëjmë për ta, pa i pyetur, sepse besojmë se e dimë. Por shumë shpesh, nuk ia qëllojmë në shenjë dhe ndodhin keqkuptime.

## **Problemet që vijnë nga mos dëgjimi**

Kush bie dakord me mua, jetojmë në një kohë kur gati askush nuk dëshiron të dëgjojë. Të gjithë duan të flasin, të tregojnë diçka ose të të mësojnë sesi duhet bërë diçka. Por shumë pak janë ata që duan të dëgjojnë.

Një varg i bukur thotë: “I shpejtë në të dëgjuar, i ngadalshëm në të folur.” Ose më saktë, të dëgjosh do të thotë jo vetëm të rrish pa folur, por gjithashtu të mos mendosh se çfarë do të thuash më pas. Nganjëherë, ndodhemi në situata ku rrimë pa folur për disa sekonda, por në ato sekonda jemi duke menduar se çfarë do të themi si kundërpërgjigje. Ky është një shqetësim i imi: shpesh rri pa folur, por nuk e gjej veten duke dëgjuar atë tjetrin, por duke menduar se çfarë do të them.

Ngri dorën nëse të ka ndodhur ndonjëherë që të bisedosh me dikë dhe ai/ajo nuk po të dëgjonte fare, fare.

Kujt i ka ndodhur? Pse kanë ngritur dorën më shumë vajzat sesa djemtë? Pse gratë po shikojnë nga burrat e tyre? “Ai e ka fajin, e di, e di. Ti flet dhe ai as që e ka mendjen.”

Të gjithë kemi qenë pjesë e një bisede ku ishte qartë që ai/ajo nuk po dëgjonte asnjë fjalë që po thoshim. Por, nëse duam të zbulojmë atë që Zoti dëshiron të bëjmë dhe të bekojmë dikë, le të bëhemi dëgjues të mirë. Të ulemi dhe të dëgjojmë me vëmendje, qëllimisht, sepse është gjë kyçe.

Në një trajnim në Maqedoni, folësi ishte një pastor nga Çikago, Erik Metcalf, që ndau një histori të rëndësishme për rëndësinë e të dëgjuarit dhe kuptuarit të nevojave të njerëzve.

Ai tregoi se kishte shkuar për të ndihmuar një lagje në një zonë të goditur nga një tornado. Fillimisht, grupi i misionarëve mendoi të dërgonte batanije, oriz, vaj, bukë dhe ujë. Por, në vend të kësaj, ata vendosën të pyesnin njerëzit se çfarë nevojash kishin ata.

Ata shkuan në lagjen e rrënuar dhe takuan njerëzit që po jetonin në kushte të rënda. Kur ata i pyetën: “Çfarë mund të bëjmë për ju?”, njerëzit fillimisht u habitën. Askush nuk i kishte pyetur më parë për nevojat e tyre reale.

Pas një momenti heshtjeje dhe ndihme nga njëri-tjetri për të artikuluar nevojat e tyre, ata thanë: “Ne kemi nevojë për mbathje, për të brendshme dhe kanatjere. Kjo është një nevojë që nuk është mbuluar deri tani.”

Përgjigjja e tyre mund të dukej e thjeshtë, por kjo ishte një nevojë e madhe dhe shpesh e anashkaluar. Erik Metcalf dhe ekipi i tij organizuan një fushatë të veçantë për të mbledhur ndihma për këtë nevojë specifike, duke u kërkuar njerëzve të dhuronin mbathje dhe të brendshme për ata që ishin në nevojë.

Ditën tjetër, kur njerëzit në lagje morën ato ndihma të veçanta, ata u ndjenë të lehtësuar dhe të vlerësuar. Ky veprim i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë ishte një ndihmë e vërtetë dhe e nevojshme për ata njerëz.

Kjo histori ilustron fuqinë e pyetjes së drejtpërdrejtë dhe dëgjimit të sinqertë për të kuptuar nevojat e vërteta të njerëzve që ndihmojmë. Nëse dëshirojmë të ndihmojmë në mënyrë të vërtetë, duhet të dëgjojmë me kujdes dhe të reagojmë ndaj nevojave që ata kanë.

Një grup misionarësh shkoi në një fshat të Indisë për t’i shërbyer një komuniteti në nevojë. Ata kishin planifikuar të ndihmonin me shumë aktivitete, duke përfshirë ndihmën për të përmirësuar kushtet e jetesës së fshatit, që kishte rreth 20 mijë banorë që jetonin në baraka dhe çadra. Plani i tyre përfshinte ndihmën për ndërtimin e një klinike për kujdesin shëndetësor, një shkollë për të mësuar shkrim e këndim dhe një kishë për t’i ndihmuar njerëzit të mësojnë për Perëndinë.

Megjithatë, një anëtar i grupit kishte një ide: të pyeste njerëzit se çfarë dëshironin ata më shumë. Reagimi i banorëve ishte i papritur. Ata thanë: “Ne duam një postë.”

“Duam një postë, duam të kemi një emër fshati dhe një adresë për fshatin. Po na ikin fëmijët dhe na dërgojnë letra, por nuk kemi një adresë për t’iu thënë. Të gjitha këto që thoni janë të mira, por na duhet një postë, sepse kjo është më e rëndësishme për ne. Jemi askund këtu, pa adresë, pa emër, pa shenjë. S’kemi si të lidhemi me botën jashtë.”

Për njerëzit e fshatit, nevoja për një adresë ishte më e rëndësishme se çdo gjë tjetër. Ata nuk donin klinikën, shkollën apo kishën në fillim. E gjithë kjo mund të dukej e lehtë për t’u realizuar, por për grupin e misionarëve ishte një proces i gjatë. U deshën dy vjet për të arritur që të realizonin regjistrimin e fshatit, për të caktuar një emër dhe adresë për të, dhe për të ngritur një sistem poste.

Pasi fshati mori adresën dhe identifikimin që dëshironte, filluan të ndodhin ndryshime të mëdha. Më vonë u ndërtuan edhe klinika, shkolla dhe kisha, por

gjithçka filloi me krijimin e një adrese që e bëri të mundur lidhjen e fshatit me pjesën tjetër të botës.

## **Stetoskopi i Doktorit**

Ai që krijoi stetoskopin njihet për thënien e tij: "Kur të përdorim këtë mjet, nuk do ndalojmë së dëgjuari pacientin, sepse ai do na e tregojnë sesi mund ta shërojmë." Ai nuk donte që doktori të dëgjonte vetëm rrahjet e zemrës dhe zhurmën e mushkërive, por donte që të dëgjohej edhe çfarë thoshin njerëzit.

Ky është një parim kyç, apo jo? Është puna ime, është puna jote që të dëgjojmë komunitetin, të dëgjojmë nevojat e njerëzve, të dëgjojmë ata që na rrethojnë. Të dëgjojmë familjen, personat te klasa, te puna, të dëgjojmë nevojat, lëndimet, plagët e atyre që Perëndia na ka vënë afër. Të dëgjojmë nevojat që kanë ata dhe jo çfarë mund të ofrojmë ne.

## **Dëgjoji të tjerët, dëgjo njerëzit që të rrethojnë.**

Kur them "dëgjo të tjerët", nuk po them vetëm "dëgjo fjalët që thonë", por dëgjo dhe lexo gjithçka që po kalojnë në jetë. Shiko se ku gjendet ai/ajo. Është si kur po kërkon të marrësh një shtëpi me qira. Cila është një nga pyetjet e para që bën kur kërkon një shtëpi me qira? "Ku ndodhet?" Kjo është një pyetje shumë e rëndësishme për njerëzit: ku janë, ku ndodhen, ku gjenden, si janë?

Në një kërkim lidhur me çiftet që ndahen, një nga shkaqet kryesore është se ata nuk e njohin gjendjen e njëri-tjetrit. Çiftet e palumtur bëjnë për njëri-tjetrin, por duke hamendësuar se çfarë mund të dëshirojë tjetri, pa pyetur se si është, ku ndodhet, si po kalon, çfarë e trazon apo çfarë e gëzon.

Ndërsa çiftet e lumtur e njohin gjendjen e njëri-tjetrit, e dinë se ku ndodhet dhe si është tjetri, dhe janë të ndjeshëm ndaj ndjenjave dhe nevojave të tij/saj. Ata nuk janë thjesht më të mirë sepse kanë dy zemra më shumë, por sepse i japin vëmendje dhe dëgjojnë njëri-tjetrin.

Ndoshta ky mund të jetë fillimi për disa prej nesh: fillo duke dëgjuar partnerin tënd, të fejuarin, të dashurën, shokun, shoqen.

Disa nga pyetjet që u bëj fëmijëve të mi çdo javë janë: "Çfarë ke arritur këtë javë? Për çfarë je krenar? Si po kalon me shokët? Çfarë pengesash po has?"

Të nxis shumë që të fillosh të pyesësh fëmijët. Mos hamendëso se e di, se kupton, por pyet qartë dhe qëllimisht për gjendjen e tyre.

Kjo ndodh edhe me njerëzit përreth. Nëse dëshiron të kuptosh cili është misioni që Zoti ka për ty aty ku je, duhet të fillosh të kuptosh, të lexosh dhe të pyesësh për gjendjen e familjes, lagjes, vendit të punës, klasës. Mos hamendëso se i di, se i njeh. Duhet të dish me siguri gjendjen e tyre.

Çfarë i gëzon? Çfarë synimesh kanë? Çfarë sfidash po hasin? Çfarë nevojash kanë?

(shënim për pastorin:  
opsionale:

*Kjo seri do jetë me life-story të ndryshme (të lidhura drejtpërdrejt me mesazhin), dua të ftoj persona që do të ndajnë momente nga jeta e tyre në lidhje me: si i ke dëgjuar të tjerët?*

Për ta ilustruar këtë do të ftoj \_\_\_\_\_.)

Troç fare: Njerëzit rreth e qark teje po ngordhin për t'i dëgjuar dikush. Prandaj pyetja mbetet:

A je duke i dëgjuar të tjerët?

Dëgjo lagjen, bllokun e pallatit, fshatin. Nuk mund ta bekosh një vend pa dëgjuar dhe parë gjendjen e njerëzve, por gjithashtu duhet të dëgjosh edhe vendet përreth, lagjen, grupin e pallateve, zonën rreth e qark ku je ti.

Ja se çfarë dua të them me këtë. Nëse ke dëshirë të dëgjosh komunitetin ose qytetin ku je, do t'ju nxisja, në fakt çdo grup të vogël, që të praktikoni një gjë të thjeshtë:

Shikoni gazetatat e përditshme, lajmet ose social media dhe shqyrtoni kryeartikujt. Përzgjidhni 6-7 kryeartikuj të një jave për t'i diskutuar në grupin tuaj të vogël. Nga këto nevoja, mendoni se për cilën mund të bëni diçka. Për cilën nga këto grupi juaj është më pasionant dhe ka më shumë interes për ta ndjekur?

Mund të zbuloni se mund të ndihmoni në një organizatë ekzistuese në një projekt ose si vullnetar për disa orë. Ose mund të identifikoni një nevojë që nuk e dinit që ekzistonte.

Shiko, nëse do të gjesh, nëse do kalosh kohë për ta dëgjuar komunitetin tënd, unë e di shumë mirë që do të gjesh dhe kuptosh cila është nevoja. Sepse vendet ku ndodhesh ti çdo ditë flasin... por ajo që të duhet është të ulësh pak ritmin e

jetës dhe të ndalojmë për të dëgjuar dhe për të kuptuar çfarë do Perëndia që të bësh ti.

## **Dëgjo çdo ditë**

Pra, për ta bekuar këtë vend, sepse për këtë gjë po flasim, Perëndia të bekon ty që të jesh bekim dhe sa më shumë që bekon, aq më shumë do të besojë Ai ty. Por si e fillojmë? Cila ishte B-ja?

B: Bjer në gjunjët e lutjes.

Po kjo që po flasim sot?

E: E dëgjojmë tjetrin, dëgjojmë lagjen, vendin ku jetojmë, në punë, në shkollë. Le të lutemi çdo ditë gjatë kësaj jave: “Perëndia im, si do Ti që ta bekoj botën sot? Më ndihmo që të të dëgjoj.” Dhe dëgjo qëllimisht. Kur të mblidheni me grupin e vogël gjatë javes, flisni bashkë se çfarë keni dëgjuar nga njerëzit dhe vendet. Dhe kjo lloj praktike nuk është thjesht për të bërë si çuna të mirë, si goca të mira; kjo është mënyra për...

Kështu do e B.E.K.O.J. Perëndia botën përreth teje çdo ditë. Kështu do e zbulosh misionin e Jezusit për jetën tënde.

Jezusi dëgjoji zërin e një njeriu në mes të një turme të madhe. Ti dhe unë mund të jemi në kontakt me shumë njerëz çdo ditë, çdo javë, me njerëz për të cilët nuk kujdeset askush, nuk i dëgjon askush. Sepse shumica e njerëzve duan të flasin, të tregojnë se çfarë kanë, sesa të zotë janë, të japin mend etj.

Por ti, ti ji ndryshe. Ji si Jezusi. Dëgjoji ata; duke i dëgjuar do të kuptosh nevojat e tyre, dhe duke i kuptuar mund të shikosh se çfarë mund të bësh.

Lutem shumë për secilin prej jush. Perëndia t’ju transformojë në njerëz që e kanë zemrën si zemra e Jezusit dhe të na përdorë ne për të prekur dhe ndryshuar jetët e njerëzve të tjerë, për të ndryshuar këtë vend, për të ndryshuar botën.

Le të bëjë eko gjatë gjithë javës pyetja e Jezusit në mendjet tona dhe të shkojmë e të pyesim të tjerët: **“Çfarë dëshiron të bëj për ty?”**

**Le të lutemi**

**Lutja e Shpëtimit.**